

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“Express Employers Services” sh.p.k

Tiranë, më datë 30/01/2024

NENI 1

Shoqëria Tregtare “Express Employers Services” **sh.p.k** (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statutit të miratuar prej saj.

NENI 2 - EMRI I SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “Express Employers Services” sh.p.k

NENI 3 - OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të mëposhtme:

Agjensi ndermjetesimi dhe punesimi.

NENI 4 - SELIA E SHOQËRISË

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Bulevardi "Deshmoret e Kombit" , Twin Towers, Tower B, kati 5, Prane BLC, Tiranë.

NENI 5 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 10.000 Lek. Kapitali ndahet në një (1) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. "1. Ilir Qafa, lindur në Berat, më 09/06/1978, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033276346, zotëron 100% të kuotave, e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej (10.000) lekë."

Kapitali themeltar është investuar nga ortakët themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është kryer nga Ortakët Themelues.

NENI 6 - KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i veprimtarisë fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.



NENI 7 - ORGANET DREJTUESE

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cilët zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i Shoqërisë është Ilir Qafa, shtetas Shqiptar, i Lindur në Berat, më 09.06.1978, me nr. personal H80609066H, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhduajnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12 - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE




Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Akt i Themelimit hartohet në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Ilir Qafa



(emer, mbiemer, firme)